



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr 1003 prot

Elbasan, më 19.04.2022

**VENDIM**

Nr 17 datë 19.04.2022

**Për**

**trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2021-2022**

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", e ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit miratimit të kërkesave online për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022, Vendimeve të Bordit të Administrimit nr 38 datë 02.11.2021 "Për procedurën e aplikimit të studentëve në Ciklin e parë të studimit për bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin 2021-2022", Relacionit të Administratorit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2021-2022" për studentët në nevojë, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

- 1- Përfitojnë bursë financiare 49 studentë me kriterë të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 66 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Në VBA nr 03 datë 12.02.2022 ndryshohet;
  - Hiqen nga lista e studentëve të skualifikuar 1 studente e cila është rikonfirmuar që plotëson kriteret dhe përfshihet në listën e fituesve për bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit.
  - Ndryshohet 1 student që nuk përfitonte bursë financiare dhe përfshihet në listën e fituesve për bursë financiare.
- 4- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 4 studentë, sipas listës bashkëlidhur.



- 5- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimin të kriterëve të studentëve sipas listës në pikën 1 , 2 të mos zbatohet vendimarrja e përfitimit, ndërsa ndryshimet në rastet e përfitimit të listës së pikës 4 të paraqiten për vendimarrje në BA.
- 6- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DURMISHI**

